



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
PRISHTINË - PRISHTINA

## **REFORMA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE NË SHQIPËRI ,FAKTOR DHE SFIDË NË RRUGËN E KONSOLIDIMIT TË DEMOKRACISË DHE INTEGRIMIT NË BE**

**Prof. Dr. Makbule Çeço**

Shkolla e Lartë Universitare 'Justicia', Tiranë, Shqipëri  
Universiteti i Tiranës, Shqipëri

### **Abstrakt:**

Shqipëria, në historinë e saj, si një shtet i centralizuar, deri në vitin 1991, që shënoi kalimin në demokraci, nuk ka trashëguar eksperiencën e një forme adequate të një qeverisjeje vendore demokratike. Fillimisht, me miratimin e Dispozitave Kryesore Kushtetuese<sup>1</sup>, dhe në vecanti, me miratimin e Kushtetutës në 1998, në të cilën janë mishëruar standardet e europiane e ndërkombëtare, dhe në vijim, me adaptimin e parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore<sup>2</sup>, dhe miratimin e një paketë ligjesh në zbatim të tyre, në kuadër të një shteti unitar e me demokraci parlamentare si formë qeverisjeje, shënohet momenti i kthesës rrënjësore në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore. Gjatë kësaj periudhe është fituar një përvojë dhe eksperiencë e pasur, mbi bazën e së cilës parashtrrohet imperativi i realizimit të një reforme të thelluar në këtë fushë. Punimi ka në fokus trajtimin e nevojës dhe dobisë së një ndarje të re administrativo-territoriale në lidhje dhe harmoni me thellimin e decentralizimit, si një faktor për fuqizimin e konsolidimit të demokracisë vendore dhe integrimin evropian, përmes analizës së rolit që ka luajtur qeverisja vendore dhe problematikës që ka bashkëshoqëruar atë gjatë 23 viteve të tranzicionit, 15 viteve të Kushtetutës së re dhe gjithë legjisllacionit përkatës.

**Fjalët kyç:** *Reforma administrative-territoriale, Demokracia vendore; Kushtetuta, Karta Europiane e Autonomisë Vendore, Intergrimi në BE.*

---

<sup>1</sup> Miratuar në 29.4.1991

<sup>2</sup> Shqipëria e nënshkroi Kartën në maj 1998 dhe Parlamenti e ratifikoi tekstin e plotë të Kartës, me të gjitha detyrimet e përcaktuara në të dhe, pa përjashtime, kufizime, pra, pa rezerva, më 11 Nëntor, 1999 me ligjin nr.8548, Për ratifikimin e "Kartës europiane të autonomisë vendore